

Merita Isaki

NDJENJA E REALITET



M e r i t a I s a k i

NDJENJA E REALITET

Nëntor
2019

*Kuptimi i jetës është gjithmonë aty.
Thjesht duhet ta gjesh.*

A je ti... ?

*Më lëndove,
Më hidhërove,
Mendoja se je besnike,
Por ti, paske qenë armike.*

*Të kam ndihmuar,
Të kam respektuar,
Dhe së fundmi
Më keni mashtruar.*

*Ndonjëherë, mendoj
Se të gjithë njerëzit,
Armiq janë bërë.*

*Këtë nuk mund ta duroj
Atëherë edhe unë, të mendoj
Në vend tjetër të shkoj.*

Babit

*Dua të shkruaj poezi
Babin tim t'ia kushtoj,
Atij që më riti,
Atij që më edukoj.
Është njeriu më i shtrenjtë në këtë planet .
Më përkrah në çdo hap të jetës,
Më ndihmon kur kam mangësi,
Më bën të lumtur, kur jam në vështërsi.
Kur në jetë, nuk mund të ta shpërblej,
Këtë mirësi, që vjen nga ti.
Me këto vargje dua të të falemenderoj,
E me këtë poezi dua të të gëzoj.*

Beso

*Beso se gjithçka,
Me mund e përpjekje,
Mund të arihet.
Për të fituar dituri,
Librat duhet të lexohen,
E pastaj, për ardhmëri,
Pa ndërprerë, duhet të luftohet.
Beso, se në jetë
Gjithçka mund të arish,
Atë gjë që dëshiron
Duhet ta provosh,
Jo pa e provuar, të thuash
Nuk mund ta realizoj.
Beso se do arish diku,
Jo me ëndërim
Por me mund,
Punë e mësim.*

Bota

*Pse është koj botë
Plot me hidhërimë,
Pse është koj botë
Plot me mashtrime.*

*Nuk ka turp, as respekt,
Ka ardhur një kohë,
Askush mes veti nuk flet.*

*Pse është gjithë ky mllef,
Gjithë ky hidhërim,
A mos vallë bota,
Është në përfundim.*

*Pse këtë gjë aspak
Nuk e mendojmë,
Vetëm mendjen e kemi
Kë me kë të hidhërojmë.*

*Ka ardhur një kohë
Shumë e vështirë,
Sepse bota është rrethuar
Me njerës pa mëshirë.*

Dëshirë

*Dua shumë libra të lexoj,
E nga to, dituri të fitojë.*

*Dua shumë libra të shkruaj,
Të tjerët të lexojnë,
E kur në jetë, të mos harojnë.*

*Të ngelet një kujtim,
Për atdheun tim.*

*Të shtohen sa më shumë njerës,
Që duan diturinë,
E të plotësojnë njohuritë.*

...Dhe unë meritoj...

***M**eritoj dije të fitoj*

***E** në suksese tjera të mos xhelozoj*

***R**realizoj ëndrën për të ardhmen time*

***I**nspirohem me mendime*

***T**ë shkruaj shumë poezi*

***A**ty një ditë dua të arijë*

(Krijim akrostik)

*Dituria nuk ka vlerë përveç
nëse e fut në praktikë.*

Diturisë

*Të mësojmë
Sepse na duhet dituri,
Me mësim të ndërtojmë,
Të gjithë së bashku ardhmëri.*

*Shkolla është vendi,
Ku të gjithë dije nxëmë,
E për nota, numra,
Në jetë të mos luftojmë.*

*Shumë duhet mësuar,
Arsimtarët t'i dëgjojmë,
Për jetë të luftojmë,
Dituri të fitojmë.*

E vërteta

*Kohëve të fundit
Është humbur e vërteta,
Njerëzit më shumë gënjejnë
Të vërtetën nuk mund ta gjejnë.*

*Nuk ka njeri që nuk ka gabuar,
Që një herë nuk është zemruar.
Më mirë të thuash të vërtetën
Por kur i thua këto fjalë,
Njerëzit thonë mos fol kot.*

Ëndrrat

*Të gjithë diçka ëndrojmë,
E ëndrrat një ditë ti realizojmë,
Ëndërat që na shpien,
Në ardhmëinë tonë.*

*Duhet të vazhdojmë,
Ëndrrën e ardhmërisë,
Jo vetëm ta ëndrojmë,
Por edhe për të, të punojmë.*

*Sa më shumë të mësojmë,
Edhe më tepër të punojmë,
Që një ditë ëndrrat tona,
Ne t'i realizojmë.*

Shkolla

*Erdhi viti i ri shkollor
Të gjithë u gëzuam,
Me shokë e shoqe
Përsëri i rritakuam.*

*Mësuesët, mësimet
Na i mësojnë,
E nota të dobëta
Nuk duan të na shënojnë.*

*Ejani shokë e shoqe,
Së bashku të mësojmë,
E pesën në fletore,
Kush i pari të shënojë.*

*Jemi fillorist,
Na duhet dituria,
Sepse me dituri,
Vjen edhe ardhmëria.*

Faji

*Faji nuk është i imi,
E ata, përsëri më fajësojnë,
Dëshirojnë të më mashtrojnë,
Të më akuzojnë, ofendojnë.
Dëshirojnë që nga zemra e miqve,
Me çdo kusht të më largojnë,
Dëshirojnë të përkulem,
Falje t'iu kërkoj.
E unë, as nuk iu përkulem,
E as falje s'iu kërkoj,
Nuk është gabimi im,
Falje t'iu kërkoj.
Me kalimin e kohës
Vetë, do ta kuptojnë
E shpresoj që një ditë,
Fajtorin, Zoti ta dënojë.*

Familja

*Gjëja më e shtrenjtë,
Në botë është familja,
Ajo më ndihmon,
Në momente të vështira.
Edhe unë familjen,
Mundohem ta ndihmojë,
Edhe pse ndonjëherë
Sa shumë gaboj,
Nuk i ndëgjojë,
Pastaj mërzitem, falje u kërkoj.
Pendohem, pse këto njerëz,
Më të shtrenjtë në botë,
Unë ti mërzis, dikush nuk i ka,
E unë t'i s'këlldis.
Ju falemenderoj nga zemra,
O ju prindër të mi,
Më ritët me mundime,
E në ditët më të vështira,
Më lumturuat jetën time.*

Gabova

*Gabova, që fola para kohe,
Njerëzit rreth meje i mërzita,
Me fjalët e pakuptimta.
U pendova, por ishte shumë vonë,
Nuk u mendova aspak,
Se koha shumë shpejt kalon.
Njerëzit me shiqimet e tyre,
Mua më qortojnë, dhe thonë;
Nuk je ti, që ke qenë si më parë,
Shumë ke ndryshuar,
Nuk je vajzë e mbarë.*

Garat

*Dëshiroj në gara
Pjesmarëse të jem,
Të provoj dituri, zgjuarsi,
Talent të krahasoj.*

*Kur arsimtari, neve na lajmëron
Që në gara do të shkojmë,
Ska më shumë dëshirë
Emocoion dhe sakrificë.*

*E pas çdo mundimi
Vjen edhe shpërblimi,
Pas çdo gare vjen
Mirënjohja, diploma
Edhe lavdërimi.*

*Mos u ngut të zësh miq, por, kur t'i zësh,
mos i braktis.*

Jeta

*Jeta ka momente të mira,
E dikur, duhet të përballesh,
Me momente të vështira.
Hapat në jetë, duhet t'i bëjsh vetë,
Jo të të ndihmoj dikush,
Që dikur, pas shpine të flet.
Duhet jetën në vendlindje
Ta shijojmë, e jo për mërgimin,
Shpesh herë të mendojmë.
Se atje nuk rrjedh qumësht e mjaltë,
Por punë, djersë, halle e mërzi,
I vetëm, pa familje e pa shtëpi.*

Jeta

*Jeta ka rrugët e veta,
Disa janë të vërteta,
E disa tjera të zhdrejta.*

*Shumë gjëra m'i mësoi,
Më mësoi të përballem,
Me gjëra të vërteta.*

*Nga një herë, me jetën hidhërohem,
E dikur me fatim e jetës, pajtohem.*

*Ashtu siç është shkruar,
Jetën do ta vazhdoj,
E kurë nuk do të ndalem,
Vetëm përpara do të shkojë.*

Koha

*Koha ëhtë gjë e shenjtë
Shumë shpejt kalon,
Kurrë në jetë nuk ndalon
Me ne, fare nuk komunkon.*

*Nuk blehet e nuk e shitet,
Nuk duhet ta lëmë të ik,
Duhet të shfrytëzohet,
Dhe më tepër duhet të çmohet.*

Lexo

*Lexo sepse na duhet dituri,
Të psurohemi me mençuri.*

*Duhet ta marim librin në dorë,
Të bëhimi të gjithë punëtor.*

*Telefonat nga duart t'i largojmë,
E librat me zell t'i lexojmë.*

Lulja

*E pashë një lule,
Shumë të bukur,
Në kopshtin tim,
Që qëndronte,
Të gjithë kopshtin,
Ajo e zbukuronte,
Ngjyrë të kuqe,
Si qershia, nga ajo lule,
Lulëzonte e gjithë shtëpia.*

Mashtrimi

*Pse po më mashtroni,
Mendoni që nuk ju kuptoj,
Thoni me vete, e mashtrova.*

*Po ti së pari, veten mashtron,
E në jetë shumë gabon.*

*Mashtrimi, nuk është gjë e mirë,
Është veprim i njerëzve,
Që në jetë nuk kanë aspak fytyrë.*

Më fal

*Më fal, nëse diku gabova,
Nëse me fjalë të lëndova.*

*Aty ku unë kam gabuar,
Di edhe falje për të kërkuar.*

*Nuk është keq të kërkohet falje,
Për gabimin që ke bërë.*

*Vetëm ashtu duhet vepruar,
E të tjerët të mos i lëndosh.*

Më lëndove

*Mendoje se më lëndove,
Thjesht, veten mashtrove.
Kur isha më e vogël,
Shumë fjalë më thonin,
E mendonin se jam fëmijë,
E nga fjalët e tyre ,
Nuk kam për t'u lënduar.
Ata fjalë, ende s'i haroj
Në mendejen time i rikujtoj.
Mendonin se janë më të medhenj,
Mund gjithkë të lëndojnë,
Ata s'kanë krenari, nuk lëndohen,
Nuk kanë ndjenja, e as nuk turpërohen.*

*Ata që dinë, bëjnë.
Ata që kuptojnë, japin mësim.*

Mësuesit

*Jam ulur në karike
E vetmuar, ri e mednoj,
Dua të krijoj një poezi
Mësuesit tim t'ia kushtoj.
Na mëson shumë gjëra
Që nuk i dinim, e nuk i dimë,
Luajmë e këndojmë,
E së bashku gjithçka mësojmë.
Mësuesi jonë, gjithmonë na ndihmon,
Dhe detyrat që nuk i dimë,
Shumë herë na spjegon,
Derisa ne të gjithë i kuptojmë,
Unë mësuesin dua ta falemenderoj,
Për gjithçka që na mësoi.*

Natyra

*Sa e bukur
Është natyra,
Kur e shikojmë
Na buzëqesh fytyra.
Natyra në fsahatin tim
Është plot gjelbërim,
Nga njëherë era na tmeron,
Kur me shpejtësi fishkëllon.
Kodrat, kodrinat, fushat,
Liqenet e lumenjtë,
Natyren na e zbukurojnë,
Nëve jetën na gëzojnë.*

Ndihmo

*Ndihmo nëse ke mundësi,
Ndihmo edhe ata që të ndihmuan,
Mos haro ata që nuk të ndihmuan.
Fali ata, që të kanë falur,
Asnjëherë mos prit shpërblim,
Nga ai, që ke ndihmuar,
Sepse të gjithë kemi nevojë,
Një ditë për ndihmë,
E ndihmën duhet pranuar.*

Nënës

*Për të gjithë poezi kam krijuar,
Por më të shtrenjtën,
Nënën time vargje nga shpirti,
Të krijoj kam haruar.
Më qëndron pranë,
Në gëzime dhe pikëllime,
Është e vetmja që bën gjithçka
E llogari, asnjëher nuk kërkon.
Edhe një mijë poezi nëse i krijoj,
Nuk janë të mjaftueshme,
Për një, siç je ti, o e dashura ime.
Ty me asgjë nuk do të ndroja
Edhe po të të humbisja,
Kujtesën për ty s'do ta haroja.
Zemra nga gëzimi
Nuk di se ç'më bën
Se ndjejë dashuri shumë të madhe
Për ty, o e dashura Nënë.*

Njeriu

Deshta të shkruaj poezi
Temë s'mund ta gjejë,
Vallë të shkruaj për njeriun,
Që në këtë botë me mashtrime jeton.

E nuk mund të merr frymë,
Nga ajri i ndotur,
Njerëzit çdo ditë e shkatrojnë.

Shumë do të doja
Në këtë botë të gjeja një njeri,
Që në jetën e tijë kur nuk ka gabuar.

Vallë ky njeri, ka haruar,
Që shumë vetë në jetë, ka lënduar.

Një njeri më del përpara e më thotë,
Unë kur në jetë s'kam gënjyer,
Haron i mjeri se po në atë moment,
Gjënjeshtren më të madhe e bëri,
Dhe një një histori jo të vërtetë rrëfeu.

Duhet ta thuash të vërtetën,
E jo të gënjejsh e mashtrosh,
Po qe se do vlera njerëzore,
Një herë në jetë të vërtetën të tregosh.

Poezia është gjithçka e çiltër dhe
shpirtërore në çdo gjë.

Piktura

*Mendoj, sa shumë mendoj,
Them, kur të ritem,
Me fjalë do pikturoj,
Fëmijëve ëndrat
T'ua pikturoj,
Ylberin me shumë ngjyra,
Në vizatime t'ua vizatoj.
Për njerëzit rroba të dizanoj,
Për natyrën, qellin e kaltërt,
Një ditë, me fjalët e mia,
Bukur ta vizatoj,
Dhe ëndrën time një ditë ta realizoj.*

Poezia

*Shumë herë jam
Shprehur me poezi,
Dhe nga vetja
Kam hequr një mërzi.*

*Në këtë poezi
Një mesazh dua ta them,
Të gjithë të zgjuar jemi
Një profesion në jetë të kemi.*

*Vetëm duhet vete
Ti japim një mundësi,
Të provojmë diçka
Ose të shkruajmë poezi,
E jo pa bërë asgjë
Të themi, nuk ka mundësi.*

Pse ?

*Pse gënjejmë,
Pse mashtrojmë,
Gabimet që bëjmë,
Me çdo kusht
Mundohemi ti mbulojmë.
Pse është kjo botë,
Plot hidhërimi e gabime.
Pyetja PSE? do ngel gjithmonë,
Njeriu këtë pyetje
Kur s'do ta haroj,
Do ta parashtojë gjithmonë.*

Puna

*Të punosh
Do të thënë të fitosh.
Nëse punon,
Gjithçka që dëshiron,
Në jetë i realizon.*

*Kush punon, në jetë fiton,
Neriu punëtor, punon
E kur, nuk pushon,
Njeriu që punon,
Jetën e tij e zbukuron.*

Sfida e jetës

*Shumë gjëra në jetë tejkalova,
Kur nuk u dorëzova,
Sfidat e jetës i përballova.
Kam patur pengesa e vështërsi,
Por i kam mundur përsëri,
Të ardhmen time, vetë ta ndërtoj,
E profesionin, që dëshiroj,
Me shpresë vetë do ta vazhdoj,
Shpresoj që një ditë,
Këtë ëndër ta realizoj.*

Shkolla

*Aty ku gjithmonë punohet,
Aty nxënësi gjithmonë mësohet,
Aty ku me dije pasurohemi,
Është shkolla ime.*

*Aty ku kam shumë kujtime,
Aty ku qëndëroj me shoqërinë time,
Aty ku mësuesi punon pa hile,
Është shkolla ime.*

*Të gjithë në shkollë,
Duhet të shkojmë,
Dituri të fitojmë,
Se pa dituri në jetë,
Nuk mund të jetojmë.*

*Lumturia ka më shumë gjasa të hyjë në
një shtëpi ku gjithmonë mbretëron një
humor i mirë.*

Shoqëria

*Shoqja ime
Shoqe besnike,
Shumë sekrete bëjmë
Akujt s'ia tregojmë.*

*Shumë budallallëqe bëjmë,
Por përsëritë njejtat,
Së bashku i përmirësojmë.*

*Ajo gjithmonë
Në vështërsi më ndihmon,
Gjithashtu edhe unë njejtë veproj,
Edhe pse ndonjëher ashpër e kritikoj.*

*Njëherë hidhërohemi
Por shpejtë na kalon,
Dhe në fund të fundit
Të dyja bashkë qëndrojmë.*

Shtëpia

*Një shtëpi e mbushur me krenari,
Në atë shtëpi ka fëmijë,
Që festat me familjen i fetojnë,
E njëri tjetrin e përgëzojnë.*

*Kjo shtëpi,
Është e mbushur me dashuri,
Gjithmonë kur festojnë,
Njëri- tjetrin e urojmë.*

*Çdo kush një shtëpi të tillë,
E dëshiron unë e kam atë,
E më mirë se shtëpia e tillë,
Për mua në jetë nuk ekziston.*

Sprovë

*Dikush di pas shpine të të godet,
E dëshiron, që tjetri të mos flet,
Dëshirojnë të tjerët t'i ngacmojnë,
E ata në heshtje të qëndrojnë,
Nuk dua të duroj, kur ata flasin,
Durimin e humbas, them që t'i godas,
Por më mirë të ri, që durimi im,
Një herë e për gjithmonë t'i vret.*

Të parët tanë

*Kanë mbetur shumë vepra,
Kanë mbetur shumë fjalë,
Kanë mbetur shumë thënie,
Nga të parët tanë.
Të njejtat kur nuk i harojmë,
Veprat e tyre do t'i lexojmë,
Fjalët e tyre gjithmonë
Në mend do ti mbajmë,
Thëniet e tyre për jetë
Gjithmonë do ti shqiptojmë,
Kur nuk do ti harojmë,
Dhe brezave që vin pas,
Të njejtat do t'ua rritregojmë.*

Varfëria

*Gjithmonë kur ushqim
Unë konsumoj
Më kujtohet varfëria,
Them me vete
Ç'bëjnë njerëzit
Që vuajnë nga uria.*

*Po për njerëzit
Që nuk kanë shtëpi,
E pyes veten;
Ç'bëjnë të mjerët
Kur bie shi?!*

*Ne brenda në dhomë
Ngrohtë qëndrojmë,
Ndërsa ata jashtë të ngrirë
Nëpër strehë të shtëpive
Mundohen të mbijetojnë.*

*Dua të kursej para
Varfanjakëve t'iu ndihmoj,
Këtë gjë një ditë
Me shpresë do e realizojë.*

Vendlindja

*O ju Mërgimtar
Vëllezër ne mërgim,
Mos u mërziteni
Për vendlindjen tuaj,
Mos mendoni se do të vijë
Ndonjë i huaj
E t'ua zë vëndin tuaj.
Kujtimet nga vendlindja
Do ti ruajmë, që kur të vini
Juve t'ua tregojmë,
Dhe shpirtin t'ua gëzojmë.
Vendlindjen e braktisët
Familjet i mërzitet,
Nënat me mall në dritare
Ju presin të vini,
Kur nga dera në shtëpi të hyni.
Ejani mërgimtar,
Me vite nuk ju kemi parë,
Ejani në vendlindjen tuaj,
Familjet gëzoni,
Vendlindjen mos e haroni.*

Vetmia

*Kur je në vetmi
Strukesh në një qosh,
Të duket vetja sikur
Të kanë hedhur në kosh.*

*Kur je në vetmi
Nuk di se çfar bën,
Vetëm si e hutuar
Gjithmon qëndron.*

*Pa asnjë shoqëri
Vetë çdo ditë ri,
Edhe fëmijërinë
S'mund ta shijosh.*

*Kur je në vetmi
Nuk di se çfar bën,
Të paktën kush e ka shijuar
E di se si është vetmia,
Prandaj zgjithja për këtë
Është tek poezia.*

Xheloz

*Jam mësuar
Me njerëz me dy fytyra,
Më ngjajsojnë
Sikur pasqyra.
Njerëzit që gjërat
E vogla i zmadhojnë
Thjeshtë më duket
Se më sfidojnë
apo më xhelozojn .
Mësohu ti kalosh,
Sfidat në jetë,
Sepse njeriu,
Nga xhelozia,
Pas shpine të flet.*

Zemrimi

*Pse është gjithë ky zemrim,
A nuk mendojmë për pajtim,
Pse është kjo xhelozia,
Për kundrazi ,
Duhet të gëzohemi,
E jo të hidhërohemi.
Nëse hidhërohesh me dikë,
S'mund të pajtohesh letë me të .
Kur mjegullat e zeza,
Do të largohen nga zemrat e njerëzve,
Kur njerëzit do të pajtohen,
Kur do vijë dita, për tjetrin,
Me gjithë shpirtë, të gëzohemi.*

Zemra

Zemra nuk ka bateri,
Që kur të mbarojnë,
Të presim, të rrifillojë,
Përsëri të punojnë.

Ajo çdo ditë punon,
Vjen dita ndalet e pushon.

Kjo zemër gjithçka duron,
Nga të këqijat e njerëzve,
Një ditë sulm pëson.

Do vijë dita që zemra
Për të gjithë të ndaloj,
E jeta e njerëzve
Në këtë botë do mbaroj.

Për autoren dhe veprën

Të nderuar adhures së fjalës së bukur po ju sjellim veprën e parë të nxënëses së shkollës sonë Meriat Isaki, si nxënëse në bankat e kësaj shkolle.

Në planprogramin e Lëndës së Gjuhës dhe letërsisë shqipe, me nxënësit klasës së gjashtë, trajtojmë temën “Si të shkruaj një poezi “ dhe si detyrë shtëpie nxënësit angazhohen që të krijojnë vargje poetike, apo më mirë të themi janë belbëzimet e para poetike të nxënësve.

E pikërisht këtu dallohen edhe nxënësit që kanë talent e dëshirojnë të krijojnë poezitë e para të tyre. Disa nga shokët e shoqet e klasës sollën poezitë e tyre, e të cilat u postuan të faqja e shkollës. Merita ishte nxënëse e ndrojtur, i mungonte guximi edhe pse në fletoren e sajë kishte tani më disa krijime poetike. Insistova të më sjell një ndër poezitë e saja, që edhe Merita ta sheh veten krah për krah me të gjithë nxënësit e gjeneratës, tefaqja e shkollës.

Diku në muaj mars, e shkriu edhe akullin e ndrojtjes së sajë, e më solli poezinë e parë “Shoqëria“, të cilën e vendosëm te faqja e shkollës. Në fytyrën Meritës shihej gëzim dhe lumturi. Pas kësaj poezie u rradhitën dhe poezitë tjera, të cilat ishin të larmishme si në temë ashtu edhe në përmbajtje.

Jo vetëm te Merita, por edhe te nxënësit tjerë, mungonte e mungon besimi se edhe ato mund të botojnë veprat e tyre, e ky pesimizëm Meritën e ka ndjekur deri në momentin kur bashkëbiseduam me prindin e saj që të angazhohemi ta nxjerrim në dritë këtë vepër.

Në të vërtetë kjo vepër është e përmbushur me ndjenja, sepse çdo varg i saj ka dalë nga burimi i ndjenjave të autores e

materializuar me realitetin e kohës ku dhe kur jeton edhe Merita.

Shumica e poezive janë reflektim i ngjarjeve dhe momenteve që arrinë ti sheh e ti kuptoj.

Nuk haron që të krijoj edhe poezi, të cilat ua kushton familjarëve.

Me që jemi një vigjilje të III vjetorit të Kongresit të Manastirit, duhet të theksojmë se një ndër temat që trajton Merita në vepren e saj, është pikërisht shkolla, të mësuarit, të krijuarit etj. Ja si shprehet, në një strofë Merita

*Shkolla është vendi
ku të gjithë dije nxëmë
e për nota, numra
në jetë të mos luftojmë.*

Rreagon edhe kur e pavërteta thuhet dhe etiketon jo vetëm autoren po edhe të tjerët, e këtë reagim e gjejmë edhe për mes vargjeve të saja në disa poezi.

Ëndër e çdo nxënësi, pra edhe e Meritës është që të merr pjesë në gara të ndryshme, tek të cilat dëshiron të shpalos aftësitë e saja dhe sheh mangësitë, e të njejtat t'i përmirësoj.

Për ndonjë gabim, ose ofendim që do të i kishte bërë dikujt pa qëllim, Merita është e gatshme të kërkoj falje publike, e këtë falje e kërkon në disa poezi të saja .

Në poezitë e saja, gjejmë edhe përkrahje të natyrës që e rrethon, tek të cilat brengoset për keqtrajtimin që i bëhet nga njerëzit e pakujdesëm dhe pret që natyra të mos dënoj ata që nuk e dëmtojnë atë.

Tema sociale është evidente në shumë poezi në këtë vepër. E brengos fati i njerëzve që nuk kanë të paktën një racion ushqim .

Po për njerëzut
që nuk kanë shtëpi,
e pyes veten
Çbejne të mjerët
Kur bie shi?!

Nuk i haron edhe arsimtarët, të cilët e ndihmojnë që të sheh botën, e të ëndrroj ardhmërinë. Edhe atyre u ka krijuar vargje, të cilët i keni në veprën letrare.

Nuk mungon edhe brenga e Meritës të trajtojë një temë shumë të dhimshme siç është mërgimi, i cili dita ditës po na zbras edhe bankat shkollore dhe mbyll shumë shtëpi. Po me këtë poezi autorja u shfaq në manifestimin i cili mbahet për nderë të Mërgimtarëve nga Treboshi këtu në Trebosh.

Përdor strofë të ndryshme sipas ndërtimit, dhe atë përdor strofën dy vargëshe, tre vargëshin, katër vargëshin dhe strofën me më shumë vargje.

Te disa krijime ndërton vargun me rrokje të njejtë, te disa krijimi vargjet janë ndërtuar me rrokje të ndryshme.

Ka përdor disa lloje të rimës.

Ju ftoj juve të nderuar lexues, të lexoni këtë vepër e të drejtreflektoni që Merita të arrijë që veprën e rradhës ta bëjë edhe më të kompletuar.

Merita, paç këmbën e mbarë, dhe dhashtë zoti të arish të tejkalojsh numrin treshifror me veprat e tua të rradhës.

Muaxher Haruni

Falemenderim

Të nderuar lexues ju falemenderoj nga zemra që lexuat librin tim të parë, emocionet e mia të para që i kam shpreh në ato poezi, pasi që poeti tek secila poezi e tij lë diçka nga vetëvetja. Këtu unë lash ndjesitë e mija, ju falemenderoj që ndatë kohë që ta lexoni veprën time të parë. Falemenderoj të gjithë ata që më mbesh teten mua dhe krijimtarin time, posaçërisht flemenderoj familjen time dhe mesuesin tim, Muhaxher Haruni me të cilin bashkpunova ne realizimin e kësaj vepre.

*Me respekt
Merita Isaki*

Përmbajtja

<i>A je ti... ?</i>	4
<i>Babit</i>	5
<i>Beso</i>	6
<i>Bota</i>	7
<i>Dëshirë</i>	8
<i>...Dhe unë meritoj</i>	9
<i>Diturisë</i>	11
<i>E vërteta</i>	12
<i>Ëndrrat</i>	13
<i>Shkolla</i>	14
<i>Faji</i>	15
<i>Familja</i>	16
<i>Gabova</i>	17
<i>Garat</i>	18
<i>Jeta</i>	20
<i>Jeta</i>	21
<i>Koha</i>	22
<i>Lexo</i>	23
<i>Lulja</i>	24
<i>Mashtrimi</i>	25
<i>Më fal</i>	26
<i>Më lëndove</i>	27
<i>Mësuesit</i>	29
<i>Natyra</i>	30
<i>Ndihmo</i>	31
<i>Nënës</i>	32
<i>Njeriu</i>	33
<i>Piktura</i>	35
<i>Poezia</i>	36
<i>Pse ?</i>	37

<i>Puna</i>	38
<i>Sfida e jetës</i>	39
<i>Shkolla</i>	40
<i>Shoqëria</i>	42
<i>Shtëpia</i>	43
<i>Sprovë</i>	44
<i>Të parët tanë</i>	45
<i>Varfëria</i>	46
<i>Vendlindja</i>	47
<i>Vetmia</i>	48
<i>Xhelozit</i>	49
<i>Zemrimi</i>	50
<i>Zemra</i>	51
<i>Për autoren dhe veprën e sajë</i>	52
<i>Falemenderim</i>	55
<i>Përmbajtja</i>	56

*Merita Isaki, nxënëse në shkollën fillore komunale
“ Fan Noli” f. Trebosh, lindi në vitin 2007 në Tetovë, jeton në
fshatin Trebosh. Është kjo vepra e parë e sajë. Krijimet
latrare të saja në prozë e poezi i ka të botuara edhe te faqja e
shkollës që nga klasa e gjashtë. Ka marrë pjesë në shumë
konkurse lertare të organizuara nga institucione të ndryshme
komunale e regjionale. Me krijimet poetike është shfaqur edhe
në shumë programe shkollore, e manifestime tjera të
organizuara në fshat. Krijimet e saja në poezi i ka lexuar
edhe në emisione të ndryshme televizive lokale. Është nxënëse
e shkëlqyshme dhe ardhmëria e potëve të rrinj.*

Falemenderojmë sponsorët që mundësuan botimin e veprës së parë të Merita Isakit, e cila është botuar në Nëntor të vitit 2019 dhe është ripërpiluar e ripërpunuar në Prill 2022.

1. *LECKER*
2. *GATEWAY GARAGE*
3. *FULDA GRUP*
4. *SAKOM TRANS*

Recenzent: *Muaxher Haruni*

Kopertinat dhe dizajini: *Gavrilo Angeloski-Gage,
Stefan Grunevski*

Rradhitja kompjuterike: *Gavrilo Angeloski-Gage,
Stefan Grunevski*

Shtypshkronja: *Tinga Dizajin*

Tirazhi: *400*



Merita Isaki, nxënëse në shkollën fillore komunale
“ Fan Noli” f Trebosh, lindi në vitin 2007 në Tetovë,
jeton në fshatin Trebosh. Është kjo vepra e parë e sajë.
Krijimet latrare të saja ne prozë e poezi,
i ka të botuara edhe te faqja e shkollës, që nga klasa e gjashtë.
Ka marë pjesë në shumë konkurse
lertare të organizuar nga institucione të ndryshme komunale.
Me krijimet poetike të saja është shfaqur
edhe në shumë programe shkollore, e manifestime tjera
të organizuara në fshat. Ka lexuar krijimet e saja, në poezi,
edhe në emisione të ndryshme televizive lokale.
Është nxënëse e shkëlqyshme dhe ardhmëria e poetëve të rinjë.